



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1041/ 7 prot.,

Datë 22.04.2026

V E N D I M
Nr. 526/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-77318-02-24-2026, me objekt “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale te Fshatrave ne Njesite Administrative te Bashkise Lezhe”, me fond limit 14,443,130.28 (katërmbëdhjetë milion e katërqind e dyzet e tre mijë e njëqind e tridhjetë pike njezet e tete) Lek pa Tvsh.

Loti I-rë: me nr. REF-77320-02-24-2026, me objekt: **Loti I-re:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Zejmen, Shengjin dhe Kolsh”, me fond limit për Lotin I-rë: 6,116,176.66 (gjashtë milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

Ankimues: BOE “TOWER” Shpk, me NIPT L21717003H, me adresa: Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6, Tiranë & “INVICTUS” Shpk me NIPT L12213005M.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Lezhë
Adresa: L. Skenderbeg, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.02.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-77318-02-24-2026, me objekt “Sherbimi i mbikqyrjes së punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale te Fshatrave ne Njesite Administrative te Bashkise Lezhe”, me fond limit 14,443,130.28 (katermbedhete milion e katerqind e dyzet e tre mije e njeqind e tridhjetete pike njezet e tete) Lek pa Tvsh.

Loti I-rë: me nr. REF-77320-02-24-2026, me objekt: **Loti I-re:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Zejmen, Shengjin dhe Kolsh”, me fond limit për Lotin I-rë: 6,116,176.66 (gjashtë milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

II.2. Në datën 12.03.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 24.03.2026 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- 1- OE "TAULANT" SHPK, 5,870,000 I skualifikuar
- 2- OE “ARENA MK” Shpk, 6,000,000 I kualifikuar
- 3- BOE “Bersant Ylli” P/F, & “XH & MILER” Shpk 5,321,073.69 I skualifikuar
- 4- OE “BN PROJECT” Shpk, me Nuis L21305035S, pa oferte ekonomike, I skualifikuar
- 5- OE “ERALD-G” Shpk, 5,395,000
- 6- OE “G B Civil Engineering” Shpk, 2,400,109.34 I skualifikuar
- 7- BOE “HYDRO-ENG CONSULTING” Shpk, & “P.C.S.COMPANY” Shpk, 5,626,882.53 I kualifikuar
- 8- OE “InfraKonsult” Shpk, 5,504,000 I skualifikuar
- 9- OE “INFRATECH” Shpk, 5,190,010.03 I skualifikuar
- 10-BOE “LENI-ING” Shpk, & “ANGERBA” Shpk, 5,871,520 I skualifikuar
- 11- OE “Noor Engineering” Shpk, 5,800,000 I skualifikuar
- 12- OE “NOVATECH STUDIO” Shpk, 5,449,322.7 I skualifikuar
- 13-BOE “STATENG” Shpk, & “ALBGOLDING 2E” Shpk, 5,993,852 I kualifikuar
- 14- BOE “TOWER” Shpk, & “INVICTUS” Shpk, 6,000,000 I skualifikuar
- 15-BOE “ZENIT&CO” Shpk, & “DERBI-E” Shpk, 6,000,000 I skualifikuar

II.4. Në datën 01.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar “Njoftim-Fituesi Paraprak” në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 24, datë 07.04.2026.

II.5. Në datën 06.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2026/6484 dhe me nr. 1041/2026 prot, datë 07.04.2026 e BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE ankimues, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1041/1 prot, datë 07.04.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.7. Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se, statusi i pagesës për ankesën me nr. Elektronik A/2026/6484 dhe me nr. 1041/2026 prot, datë 07.04.2026 e BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, rezulton **“Paparqitur mandat pagesë”**.

II.8. Me shkresën nr. 1041/3 prot., datë 21.04.2026 lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, Komisioni, iu drejtua sektorit të Financës për informacion mbi statusin e pagesës.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 4249/6 prot., datë 16.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1041/2 prot., datë 17.04.2026 me objekt *“Kthim përgjigje”*, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar pranë KPP-së, informacioni mbi trajtimin e ankesës së BOE ankimues “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë për shkak të **mosplotësisimit të kushteve formale** siç është dokumenti bankar “mandat pagesa”, duke mos marrë parasysh këtë formular ankese.

[.....Me datë 09.04.2026 bazuar në nenin 94/4, të VKM-së 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëpërmjet sistemit elektronik të nkesave ju është kërkuar BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, të paraqesë brenda dy ditëve mandatin e pagesës.....]

II.10. Sekori i Financës informon me shkresën kthim përgjigje me nr. 1041/4, prot., datë 22.04.2026, ndër të tjera se: “ [...] Për ankesën me nr. 1041/2026 protokolli, datë 07.04.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6484, BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, nuk ka paraqitur dokument bankar në seksion mandat pagese. Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e datës 20.04.2026 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 15.04.2026, ku rezulton se, BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, **nuk ka kryer pagesë për ankesën e sipërcituar në favor të Komisionit të Prokurimit Publik**” ...

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e administruar në datën 07.04.2026 nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave nga BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, me nr. Elektronik A/2026/6484 dhe me nr. 1041/2026 prot, datë 07.04.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-77318-02-24-2026, me objekt “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale te Fshatrave ne Njesite Administrative te Bashkise Lezhe”, me fond limit 14,443,130.28 (katermbedhete milion e katerqind e dyzet e tre mije e njeqind e tridhete pike njezet e tete) Lek pa Tvsh.

Loti I-rë: me nr. REF-77320-02-24-2026, me objekt: Loti I-re: “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Zejmen, Shengjin dhe Kolsh”, me fond limit për Lotin I-rë: 6,116,176.66 (gjashtë milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e

ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 4249/6 prot., datë 16.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1041/2 prot., datë 17.04.2026 me objekt “Kthim përgjigje”, (Vendimi i KSHA), dërguar me shërbim postar pranë KPP-së, informacioni mbi trajtimin e ankesës së BOE ankimues “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë për shkak të **mosplotësimit të kushteve formale** siç është dokumenti bankar “mandat pagesa”, duke mos marrë parasysh këtë formular ankese.

[.....Me datë 09.04.2026 bazuar në nenin 94/4, të VKM-së 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëpërmjet sistemit elektronik të nkesave ju është kërkuar BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, të paraqesë brenda dy ditëve mandatin e pagesës.....]

III.1.3. Gjithashtu, Sekori i Financës informon me shkresën kthim përgjigje me nr. 1041/4, prot., datë 22.04.2026, ndër të tjera se: “[...] Për ankesën me nr. 1041/2026 protokolli, datë 07.04.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6484, BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, nuk ka paraqitur dokument bankar në seksion mandat pagese. Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e datës 20.04.2026 të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 15.04.2026, ku rezulton se, BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, **nuk ka kryer pagesë** për ankesën e sipërcituar në favor të Komisionit të Prokurimit Publik” ...

III.1.4. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për

ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar.

Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës me nr. 4249/6 prot., datë 16.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1041/2 prot., datë 17.04.2026 me objekt "*Kthim përgjigje*", (Vendimi i KSHA), autoriteti kontraktor ka dërguar informacion me shërbim postar, duke informuar se i ka dërguar njoftim BOE ankimes, mbi korrigjimin e të metave të formularit të ankesës dhe i ka lënë dy ditë për të paraqitur mandat pagesën. Pra rezulton se, autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes komunikimit i ka kërkuar BOE ankimes, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar (më datë 09.04.2026 sipas printsreen) BOE ankimes përmes komunikimit elektronik, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës.

Komunikimi i AK me OE

Veprimi	Krijuar me	Krijuar nga	Mesazhi	Dërguar në e-Albania
Kërkoni mandat pagesën	09/04/2026 16:00:52	K57829503W - Bashkia Lezhe	<p>Bazuar ne ligjin nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", ne nenin 94/4 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet se "Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin.</p> <p>Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet.</p> <p>Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës", pas administrimit te ankeses per proceduren e prokurimit me objekt: Loti I-re: "Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: "Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Zejmen, Shengjin dhe Kolsh", me numer REF-77320-02-24-2026, u konstatua se ankesa nuk është shoqëruar me mandat pagesën.</p> <p>Sa me siper, bazuar ne nenin 94/5 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, kerkojme paraqitjen e mandat pageses brenda 2 diteve nga marrja e ketij njoftim.</p> <p>Bejme me dije se nese ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.</p> <p>Duke ju falenderuar per bashkepunimin.</p>	<input type="checkbox"/>

Gjithashtu, me shkresën përcjellëse me nr. 4249/6 prot., datë 16.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1041/2 prot., datë 17.04.2026 me objekt "*Kthim përgjigje*", (Vendimi i KSHA), autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se ka trajtuar ankesën e BOE ankimues dhe në përfundim **ka vendosur refuzimin e saj**, (Vendimi i KSHA me nr. 4249/5 prot., datë 16.04.2026; Vendimi nr.02, datë 16.04.2026), për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga BOE ankimues.

Sa më sipër, konstatohet se BOE ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje më përcaktimet e pikës 2, të nenit 111, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga BOE ankimues pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës, rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “TOWER” Shpk & “INVICTUS” Shpk, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-77318-02-24-2026, me objekt “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale te Fshatrave ne Njesite Administrative te Bashkise Lezhe”, me fond limit 14,443,130.28 (katërmbëdhjetë milion e katërqind e dyzet e tre mijë e njëqind e tridhjetë pike njezet e tete) Lek pa Tvsh.
Loti I-rë: me nr. REF-77320-02-24-2026, me objekt: Loti I-re: “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Zejmen, Shengjin dhe Kolsh”, me fond limit për Lotin I-rë: 6,116,176.66 (gjashtë milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

